



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 214, Datë 14.10.2024

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“AXPO ALBANIA” SH.A. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË  
ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1315/3 prot., datë 04.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimi të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1315/2 prot., datë 27.09.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Vlen të theksojmë se kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme në këtë veprimtari, deri më datë 20.12.2024.
- Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 20.06.2024 për rinovimin e licencës, referuar nenit 16, pikës 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, ku përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, ka paraqitur aplikim për licencim nga e para.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria duhet të plotësojë informacionin/dokumentacionin në vijim:

## **NENI 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

#### **Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë**

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative në gjuhën shqipe, origjinale ose të njësuar me origjinalin.

#### ***Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal***

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë saktësimet përkatëse për sasinë e energjisë që parashikon të tregtojë gjatë 5 viteve të licencës, si dhe të dokumentojë mbështetjen financiare për ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 muaj.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të plotësojë planin e biznesit me parashikimin vjetor të të gjitha kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e veprimtarisë.

**Pika 2.5.** Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në parashikimin e energjisë elektrike që do të tregtojë vitin e parë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “AXPO ALBANIA” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**